



Ndërtesa e Elektrokovës
Bulevardi Bill Clinton nr.5
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

*Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.5
Prishtina 10000
Republic of Kosovo*



Aplikimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2026

Janar, 2026



Përmbajtja:

1. Hyrje	3
2. Kostot operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX).....	4
2.1. Shpenzimet Operative dhe të mirëmbajtjes gjatë vitit 2025	4
2.2. Kostot që ndërlidhen me hapjen e tregut.....	5
2.3. Shpenzimet e personelit	7
2.4. Kërkesat për Shpenzimet Operative 2026.....	10
2.4.1. Efekti i rritjes së pagës minimale në Republikën e Kosovës	12
3. Kostot e Zhvlerësimit dhe Kthimit.....	12
4. Kostoja e humbjeve.....	13
5. Kostot tjera.....	16
5.1. Të hyrat e parregulluara	16
5.2. Obligimet ndaj Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit	17
6. Faktori korigjues i të hyrave – KREV	17
7. Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026.....	19



1. Hyrje

KEDS i licencuar si Operator i Sistemit të Shpërndarjes nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), ka përgatitur Aplikimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për vitin 2026, në përputhje me Shtojcën 7 të Rregullës për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për të hyrat e OSSH-së) dhe udhëzimet e dhëna nga ZRRE në letrën zyrtare të datës 15 dhjetor 2025.

Ky aplikim përfshin gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për të siguruar që shpenzimet e paraqitura janë të arsyeshme, transparente dhe të domosdoshme për funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes dhe ofrimin më të mirë të shërbimeve për të gjithë konsumatorët.

Përmes këtij aplikimi, OSSH synon të sigurojë mbulimin e të gjitha kostove operative dhe kapitale që janë të nevojshme për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes, si dhe për ofrimin e shërbimeve të pandërprera dhe me cilësi për konsumatorët. Gjithashtu, aplikimi është në përputhje me parametrat rregullativë të miratuar për periudhën 2023–2027, të cilët janë përshtatur për të reflektuar ndryshimet e fundit të kostove dhe nevojave operative.

Aplikimi është strukturuar në kapituj të ndarë sipas kategorive kryesore të kostove dhe kërkesave për të hyrat e lejuara maksimale. Secili kapitull përmban analiza të detajuara dhe justifikime për kostot e propozuara. Duke qenë se procesi tarifor është interaktiv ndërmjet ZRRE-së dhe të licencuarve të tjerë, ky aplikacion mund të përshtatet tutje me qëllim të reflektimit të kostove që janë të ndërlidhura me të licencuarit e tjerë.

Aplikimi synon të sigurojë një bazë të fortë dhe të qëndrueshme për procesin tarifor të vitit 2026, duke garantuar që çdo element i kostove të propozuara të jetë i justifikuar dhe në përputhje me qëllimin e përmirësimit të shërbimeve për të gjithë konsumatorët.

Ky aplikim paraqet kërkesën për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026, bazuar në kostot reale operative, kapitale dhe të humbjeve, të cilat kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme për shkak të luhatjeve të çmimeve në treg, rritjes së pagës minimale dhe faktorëve të tjerë të jashtëm. Këto ndryshime janë jashtë kontrollit të OSSH-së dhe nuk mund të mbulohen vetëm nga rritja e inflacionit të aprovuara në MYT3. Andaj, ky aplikim nuk mund të konsiderohet si kërkesë për rritje të luksit, por për sigurimin e funksionimit minimal të rrjetit dhe sigurimit të furnizimit.



2. Kostot operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX)

ZRRE gjatë vitit 2022, përmes shqyrtimit periodik ka përcaktuar kostot operative për periudhën 2023-2027, të cilat janë përcaktuar si vazhdimësi e kostove operative të periudhës së dytë rregullative. Megjithatë, OSSH edhe gjatë procesit të përcaktimit të këtyre kostove ka argumentuar se kemi rritje të shpenzimeve operative përgjatë viteve, ZRRE ka lejuar nivele më të ulëta se ato të propozuara nga OSSH duke e vënë në rrezik serioz mbarrëvajtjen e operimeve të OSSH-së për pesë vitet e ardhshme për të përmbushur objektivat operative dhe rregullative.

Në përputhje me Rregullën për të Hyrat e OSSH-së, çdo kosto e paraqitur duhet të jetë e arsyeshme, e domosdoshme dhe e lidhur me ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes. Për rrjedhojë, OSSH ka paraqitur vetëm ato shpenzime që janë të pashmangshme për operimin e sistemit dhe që reflektojnë realitetin e tregut, duke përfshirë rritjet e jashtëzakonshme të çmimeve të inputeve, të cilat janë jashtë kontrollit të OSSH-së.

2.1. Shpenzimet Operative dhe të mirëmbajtjes gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë rritur ndjeshëm si rezultat i luhatjeve të çmimeve në treg, të cilat kanë ndodhur jashtë kontrollit të OSSH-së. Edhe pse ZRRE aplikon indeksimin me inflacion, ky mekanizëm nuk mjafton për të reflektuar rritjen reale të çmimeve, pasi inflacioni është një tregues makroekonomik që nuk pasqyron luhatjet specifike dhe disproporcionale të çmimeve në sektorin e energjisë dhe në inputet teknike. Për disa produkte dhe shërbime kritike, rritja e çmimeve ka arritur deri në 100% krahasuar me vitin 2022, vit bazë për OPEX-in në kuadër të MYT3. Për rrjedhojë, mbulimi vetëm përmes inflacionit rezulton në nën-mbulim të kostove reale operative, duke rrezikuar realizimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes dhe sigurinë e furnizimit.

Mosadresimi i këtij boshllëku krijon rrezik të drejtpërdrejtë që OSSH-ja të operojë me nën-mbulim strukturor të kostove, duke rezultuar në humbje operative dhe cenim të qëndrueshmërisë financiare. Kjo redukton aftësinë e operatorit për të përmbushur obligimet rregullative, përfshirë mirëmbajtjen adekuate të rrjetit dhe realizimin e planeve operative, duke rrezikuar cilësinë dhe sigurinë e furnizimit ndaj konsumatorëve. Në afat të mesëm, kjo mospërputhje ndërmjet kostove reale dhe të hyrave të lejuara rrezikon të transferojë pasojat financiare duke rrezikuar ndikimin negativ në cilësinë e shërbimeve ndaj konsumatorëve, çka bie ndesh me objektivat themelore të kornizës rregullative dhe interesin publik.

Gjatë vitit 2025, numri i konsumatorëve të lidhur me rrjetin e shpërndarjes dhe numri i furnizuesve në treg janë rritur krahasuar me vitin paraprak, duke rritur në mënyrë të ndjeshme volumet e punës për OSSH, si në aspektin e leximit, kërkesave për kyçe të reja, verifikimeve dhe shërbimeve të tjera operative. Kjo rritje e kërkesës ka sjellë një ngarkesë shtesë mbi kapacitetet ekzistuese, duke kërkuar angazhim operativ dhe financiar shtesë. Rrjedhimisht, duke ndikuar ndjeshëm në rritjen e



volumit të përgjithshëm të punës për OSSH, si në aspektin e leximit, kërkesave për kyçje të reja në rrjet, verifikimet dhe identifikimet, ashtu edhe në aspektin e shpenzimeve operative të ndërlidhura me to.

Për më tepër, sfidat teknike dhe operative të KOSTT (Operatori i Sistemit të Transmetimit) kanë rezultuar në kërkesa ad-hoc ndaj OSSH-së për alokimin dhe shpërndarjen e kapaciteteve në zonat e mbingarkuara, në baza ditore. Këto kërkesa kanë detyruar stafin të punojë në kushte të jashtëzakonshme, me orë të zgjatura dhe ndërhyrje emergjente, duke rritur shpenzimet operative përtej niveleve të lejuara nga ZRRE. Situata e krijuar në zonat e Gjilanit, Prizrenit dhe Gjakovës pritet të vazhdojë të jetë sfiduese edhe në vitin pasues, prandaj njohja e këtyre kostove është e domosdoshme për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të operatorit.

Sfidat e përmendura dhe kostot e lidhura me këto shërbime, të cilat nuk ishin parashikuar në shpenzimet operative të lejuara për vitin 2025, rezultuan me një rritje shtesë të OPEX-it prej 7 milion euro. Kjo rritje thekson nevojën për një vlerësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës nga ana e ZRRE-së, duke marrë parasysh stabilitetin financiar dhe kapacitetin e operatorit për të përmbushur detyrimet ndaj konsumatorëve. Në këtë kontekst, njohja e këtyre kostove si të lejuara është e domosdoshme për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të rrjetit, në përputhje me detyrimet ligjore të OSSH-së për sigurimin e një rrjeti të qëndrueshëm dhe të besueshëm (neni 28 i Ligjit për Energjinë Elektrike).

Në të njëjtën kohë, rritja e kërkesës për shërbime dhe nevoja për modernizim teknologjik kërkojnë investime dhe mirëmbajtje shtesë për integrimin e sistemeve të menaxhimit të shpërndarjes dhe infrastrukturës së avancuar të matjes. Për këtë arsye, ZRRE duhet të mbështesë një rishikim të nivelit të shpenzimeve operative të lejuara, duke i përshtatur ato me nevojat reale të OSSH-së dhe me kornizat ligjore dhe rregullative, në mënyrë që të sigurohet një performancë e qëndrueshme dhe një furnizim i cilësisë së lartë për konsumatorët.

Duke pasur parasysh sfidat operative, rritjen e kërkesës për shërbime dhe nevojën për modernizim të teknologjive, ZRRE duhet të konsiderojë rishikimin e nivelit të shpenzimeve operative të lejuara, duke i përshtatur ato me nevojat reale të OSSH-së dhe me kërkesat e kornizës ligjore dhe rregullative. Kjo do të sigurojë qëndrueshmërinë financiare të operatorit dhe mbrojtjen e interesit publik për një furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor.

2.2. Kostot që ndërlidhen me hapjen e tregut

Hapja e tregut të energjisë elektrike ka krijuar një sërë detyrimesh dhe procese të reja operative për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), të cilat janë plotësisht jashtë kontrollit dhe diskrecionit të OSSH-së dhe nuk kanë qenë pjesë e aktiviteteve të rregullta operationale në periudhat e mëparshme rregullatore. Për këtë arsye, njohja e kostove shtesë operative (OPEX) të shkaktuara drejtpërdrejt nga procesi i hapjes së tregut është e domosdoshme për të garantuar përmbushjen e obligimeve ligjore dhe funksionale të OSSH-së.

Gjatë procesit përgatitor për hapjen e tregut të energjisë elektrike, si dhe gjatë operimit të tregut të



hapur, Operator i Sistemit dhe Shpërndarjes (OSSH) ka identifikuar një sërë kostosh shtesë të cilat nuk kanë qenë të parashikuara dhe nuk janë të mbuluara nga tarifat aktuale. Këto kosto kanë lindur si pasojë e detyrimeve të reja operationale dhe regulatorike që lidhen me tranzicionin drejt tregut të hapur, si dhe nga nevoja për të siguruar një funksionim të qëndrueshëm, të sigurt dhe transparent të tregut. OSSH-ja ka informuar ZRRE-në për këto sfida që në fazën fillestare të përgatitjes së hapjes së tregut, duke kërkuar që ato të reflektohen në procesin tarifor.

Në praktikë, për të realizuar me sukses hapjen dhe operimin e tregut të hapur, OSSH-ja ka ndërmarrë aktivitete të jashtëzakonshme operationale, të cilat përfshijnë identifikimin dhe verifikimin e konsumatorëve në terren, verifikime të përsëritura, shkyçje dhe rikyçje, leximet dhe prerjet e gjendjes në kohë reale, si dhe operime jashtë planit të leximeve. Këto veprime kanë kërkuar mobilizim të shtuar të stafit, duke përfshirë operim në orare të ndryshme dhe gjatë fundjavave, për të përmbushur të gjitha detyrat dhe aktivitetet ditore, si dhe për të garantuar vazhdimësinë e procesit të tregut.

Për shkak se aktivitetet e lidhura me tregun nuk kanë qenë të planifikuara në mënyrë të detajuar në kuadër të strukturës tarifore ekzistuese dhe si rezultat i tranzicionit, i gjithë OSSH-ja është mobilizuar për të përmbushur kërkesat e procesit dhe për të siguruar funksionimin e rregullt të tregut të hapur. Në këtë kontekst, është e qartë se kostot shtesë të shkaktuara gjatë këtij procesi janë të paevitueshme dhe të domosdoshme për realizimin e detyrave të reja operationale. Prandaj, kërkohet që këto kosto të njihen dhe të reflektohen në tarifë, në mënyrë që OSSH-ja të mos mbetet e ekspozuar financiarisht për shpenzime që janë të domosdoshme për zhvillimin, stabilitetin dhe funksionimin efikas të tregut të hapur.

Procesi përgatitor për hapjen e tregut ka filluar që nga muaji maj 2025 dhe ka vazhduar intensivisht deri në qershor 2025, duke përfshirë identifikimin e konsumatorëve të prekur nga liberalizimi, verifikime të shumta në terren, koordinim me furnizuesit dhe institucionet përkatëse, si dhe përgatitjen e sistemeve dhe procedurave të reja operative. Këto aktivitete janë intensifikuar ndjeshëm pas datës 16.08.2025, kur një numër i konsiderueshëm konsumatorësh kanë mbetur pa furnizues, duke imponuar nevojën për ndërhyrje të menjëhershme për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve, si dhe për një gatishmëri të vazhdueshme operative në terren.

Duhet theksuar se këto procese janë krejtësisht të reja për OSSH-në dhe nuk kanë qenë pjesë e aktiviteteve ditore historike, mbi të cilat janë bazuar parashikimet e mëparshme të OPEX-it. Si rezultat, OSSH-ja është detyruar të rishikojë strukturën e personelit dhe të angazhojë burime shtesë njerëzore për të mbuluar funksionet e reja që lidhen drejtpërdrejt me hapjen e tregut, përfshirë menaxhimin e konsumatorëve pa furnizues, koordinimin me furnizuesit, AAM dhe përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave.

Për më tepër, hapja e tregut ka sjellë një rritje të ndjeshme të ngarkesës së punës për stafin ekzistues, ku një numër i konsiderueshëm punonjësish kanë operuar me orare të zgjatura pune për të përmbushur kërkesat për ofrimin e profileve të ngarkesës, të dhënave operative dhe asistencës teknike ndaj furnizuesve, KOSTT-it dhe ZRRE-së. Këto angazhime shtesë kanë gjeneruar kosto reale dhe të pashmangshme operative, të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me procesin e liberalizimit të tregut. Edhe përkundër mungesë së stafit, përgjatë kësaj periudhe OSSH-ja kishte mobilizuar të gjitha departamentet për të ofruar mbështetje në procesin e hapjes së tregut dhe



stabilitetin e tregut. Ky mobilizim dhe mbështetje, ndikon edhe në proceset tjera, rrjedhimisht, një pjesë e burimeve operative janë angazhuar jashtë funksioneve të tyre të rregullta, duke kufizuar kapacitetin për trajtimin e proceseve tjera në nivelin optimal, andaj është e domosdoshme sigurimi i resurseve tjera njerëzore për të mbuluar aktivitetet e reja. Rrjedhimisht, me hapjen e tregut, OSSH-ja ofron shërbime për të gjithë furnizuesit që operojnë në treg për dallim me periudhën paraprake para hapjes së tregut. Në këtë kontekst, çdo kërkesë e furnizueseve kërkon vëmendje dhe trajtim të shpejtë, ndërsa në mungesë të stafit profesional, kjo gjë nuk është e mundur.

Gjithashtu, si pasojë e nevojave të reja operative dhe avancimit teknologjik të imponuar nga hapja e tregut, OSSH-ja ka zhvilluar dhe është duke vënë në funksion disa platforma elektronike për shkëmbimin e të dhënave dhe mbështetjen e funksionimit të tregut. Në këtë kontekst, veçohet platforma SSI (Supplier Service Interface), e cila u mundëson furnizuesve, KOSTT-it dhe ZRRE-së qasje të drejtpërdrejtë, transparente dhe të standardizuar në të dhëna operative kritike. Zhvillimi, mirëmbajtja dhe operimi i këtyre platformave përbëjnë kosto shtesë operative, të domosdoshme për funksionimin e sigurt dhe efikas të tregut të hapur.

Në këtë kuadër, kërkohet që kostot shtesë operative të shkaktuara nga hapja e tregut të njihen si kosto të justifikuara, të paevitueshme dhe jashtë kontrollit të OSSH-së, në përputhje me parimet rregullatore të kostos së arsyeshme, mbulimit të obligimeve ligjore dhe garantimit të stabilitetit operativ të sistemit të shpërndarjes.

2.3. Shpenzimet e personelit

Në kuadër të kategorisë shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë të përfshira edhe shpenzimet e personelit si një nga kategoritë më të ndjeshme që ndikon drejtpërdrejt në performancën operative të kompanisë, duke e vënë në lëvizje stafin profesional të kompanisë në përmbushjen e caceve rregullative por edhe komerciale të kompanisë. Paga është një ndër faktorët kryesor e cila ndikon drejtpërdrejt në motivimin e punonjësve. Në periudhat e fundit, për OSSH është gati e pamundur të motivoj punonjësit për faktin se ZRRE-ja nuk kishte lënë hapësirë shumë herë për rritje të pagave për punonjësit e kompanisë sonë. Marrë në konsideratë se qëllimi i kompanisë sonë është ngritja e cilësisë së shërbimeve dhe për të reflektuar kënaqësinë e konsumatorëve, atëherë një gjë e tillë nuk është lehtë e arritshme përderisa ekziston pakënaqësi e stafit profesional të OSSH në aspektin e kompensimit të pagës krahasuar me kompanitë tjera në fushën e njëjtë por edhe më gjerë.

Duke qenë se paga mesatare në KEDS është dukshëm më e ulët në raport me kompanitë tjera në fushën e energjisë por edhe në sektorin privat, në vazhdimësi kemi pranuar kërkesa nga përfaqësuesit e punonjësve të kompanisë sonë për rritjen e pagave. Kërkesa për rritjen e pagave është e mbështetur në zhvillimet e fundit që ndërliken me rritjet e pagave qoftë në fushën e energjisë, në administratën publike në RKS, por edhe rritjen e kostos së jetesës në Kosovë.

Rritja e propozuar e kostos së personelit me synim të rritjes së pagave për punëtorët e KEDS përbën një masë të domosdoshme dhe proporcionale për ruajtjen e qëndrueshmërisë operative të



sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, përmbushjen e standardeve të cilësisë së shërbimit dhe reflektimin e ndryshimeve të thella që kanë ndodhur në tregun e punës dhe në koston reale të jetesës. Kjo kërkesë bazohet në fakte të matshme operative, krahasime sektoriale dhe zhvillime makroekonomike, dhe është plotësisht në përputhje me parimet rregullative të kostove të arsyeshme dhe efikase.

Punëtorët e KEDS, veçanërisht inxhinierët dhe teknikët, mbajnë barrën më të rëndë operative në sektorin energjetik përmes punës intensive në terren, ndërhyrjeve emergjente 24/7, ekspozimit të vazhdueshëm ndaj rreziqeve elektrike dhe përgjegjësisë direkte ndaj konsumatorëve finalë. Pavarësisht kësaj, niveli i pagave të tyre mbetet dukshëm më i ulët krahasuar me operatorët e tjerë të sektorit. Inxhinierët e KEDS paguhen mesatarisht deri në 30% më pak, ndërsa teknikët deri në 25% më pak sesa homologët e tyre në kompanitë publike, duke krijuar një disbalancë strukturore të vazhdueshme brenda të njëjtit sektor të rregulluar.

Kjo disbalancë ka prodhuar pasoja konkrete dhe të dokumentuara në ruajtjen e stafit profesional. Gjatë viteve të fundit, një numër jo i vogël i stafit të kualifikuar të KEDS, pas fitimit të përvojës dhe trajnimeve profesionale, kanë lëshuar kompaninë dhe janë transferuar tek operatorë të tjerë ose kompani në të njëjtën fushë, kryesisht për shkak të kushteve më të favorshme të kompensimit. Ky trend dëshmon qartë se KEDS po shërben faktikisht si një “qendër trajnimi” për sektorin, pa pasur mundësinë reale për të mbajtur stafin e përgatitur.

Në praktikë, KEDS e ka të pamundur të ofrojë paga të dinjitetshme dhe konkurruese edhe në rastet kur punëtorët paralajmërojnë largimin, jo për mungesë vullneti menaxherial, por për shkak të kufizimeve që rrjedhin nga korniza rregullative në fuqi lidhur me mundësinë e rritjes së pagave. Kompania nuk disponon asnjë mekanizëm ligjor për të parandaluar lëvizjen e lirë të punëtorëve, ndërkohë që niveli i kostos së personelit është përcaktuar nga ZRRE në vitin 2022 për gjithë periudhën rregullative 2023–2027. Kjo situatë e ka kufizuar rëndë fleksibilitetin e KEDS për t’iu përgjigjur ndryshimeve të shpejta dhe të paparashikuara në tregun e punës.

Megjithëse, vendimmarrja e ZRRE-së në vitin 2023 nuk mund të konsiderohet e padrejtë në momentin e marrjes së saj, kushtet mbi të cilat ajo është bazuar kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore. Tregu i punës ka pësuar transformime të dukshme, të reflektuara edhe në politikat publike. Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë vendime të rëndësishme për rritjen e pagave në administratën publike dhe për rritjen e pagës minimale, duke vendosur një standard të ri referimi për kompensimin e fuqisë punëtore në nivel vendi. Këto zhvillime kanë ushtruar presion shtesë mbi sektorin privat dhe operatorët e rregulluar, përfshirë KEDS, duke e bërë edhe më të thellë hendekun ekzistues të pagave.

Në të njëjtën kohë, rritja e ndjeshme e kostos së jetesës ka ulur realisht fuqinë blerëse të punëtorëve. Megjithëse inflacioni i matur zyrtarisht është raportuar rreth 2.14% në vit, çmimet reale të mallrave dhe shërbimeve bazë kanë pësuar rritje kumulative shumë më të larta, që në terma praktikë i afrohen dyfishimit krahasuar me vitin 2023. Në këtë kontekst, një pagë prej 500 eurosh në vitin 2023 siguron mbulim dukshëm më të gjerë të shportës bazë të konsumit sesa e njëjta pagë nominale në vitin 2025, duke nënkuptuar një rënie të konsiderueshme të pagës reale.

Rritja e propozuar e pagave nuk përfaqëson rritje të pajustifikuar të kostove apo tejkalim të parimeve rregullative, por një përshtatje të domosdoshme për ruajtjen e stabilitetit operacional,



parandalimin e humbjes së kapitalit njerëzor dhe sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit. Mosmiratimi i kësaj kërkesë do të rezultonte në kosto shumë më të larta afatmesme dhe afatgjata për sistemin, përfshirë rrezikun për cilësinë, sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike.

Duke marrë parasysh disbalancën e dokumentuar të pagave në sektor, ndryshimet e thella në tregun e punës, rritjen reale të koston të jetesës dhe kufizimet rregullative ekzistuese, rritja e pagave për punëtorët e KEDS duhet të konsiderohet si një kosto e arsyeshme, e justifikueshme dhe e pashmangshme. Miratimi i saj është thelbësor për ruajtjen e qëndrueshmërisë afatgjate të KEDS dhe për garantimin e një shërbimi të sigurt, të besueshëm dhe cilësor për konsumatorët. Rrjedhimisht, nevoja për rritje të pagave është jashtë kontrollit të KEDS, kjo është masë preventive për të mos humbur edhe më teje stafin profesional, për të motivuar dhe për të mbajtur në punë stafin ekzistues. Përmes rishikimit të pagave, shpresojmë të kemi mundësi edhe punësimin e kuadrove tjera profesionale edhe nga tregu konkurrues.

Mos rritja e pagave për punonjësit e KEDS, shfaq rrezikun e demotivimit të tyre dhe si pasojë e kësaj, siç ka ndodhur kohëve të fundit, një numër i konsiderueshëm i ekspertëve të fushave kyçe mund të largohen edhe më teje nga KEDS duke kërkuar kushte më të mira të pagave. Lëvizshmëria e punonjësve ka arritur nivele shqetësuese, me një rritje të vazhdueshme që ka tejkaluar 8% në vit të largimit të punëtorëve përgjatë dy viteve të fundit. Kjo situatë në vazhdimësi do të krijojë boshllëqe të theksuara në kapacitetin e brendshëm të stafit për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme, ndërkohë që rrit kostot e rekrutimit dhe trajnimit, duke vënë presion shtesë mbi burimet financiare dhe menaxheriale. Për më tepër, paqëndrueshmëria e shkaktuar nga ky nivel i lartë lëvizshmërie po ndikon negativisht në moralin e stafit të mbetur, i cili po përballët me ngarkesa më të larta pune, duke krijuar pasiguri dhe demoralizim. Rritja e inflacionit, sfidat në mbajtjen e fuqisë punëtore dhe diferencat në paga me tregun e industrisë, ndikon jo vetëm në performancën e përgjithshme, por edhe në aftësinë e OSSH-së për të ruajtur standardet e cilësisë së shërbimit dhe për të përmbushur pritshmëritë rregullative dhe të konsumatorëve.

Sipas rregullës për të hyrat e lejuara maksimale, gjatë shqyrtimit tarifar për vitin 2025, ZRRE ka përshtatur kostot e OPEX (ku përfshihen edhe kostot e personelit) duke reflektuar normën vjetore të inflacionit, e cila nuk adreson mjaftueshëm aktualitetet dhe reflektimin e ndryshimit të kostove në Kosovë, sfidat ekonomike dhe dinamiken e tregut të punës. Duhet pasur parasysh se vetëm përshtatja për reflektimin e inflacionit, nuk merr parasysh rritjen e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve specifike për sektorin e energjisë, si dhe kostot në rritje të mirëmbajtjes dhe teknologjisë, që do të thotë se kostoja është më e lartë krahasuar me normën e inflacionit që aplikohet. Kjo diskrepancë vjen duke u rënduar edhe më teje me aplikimin e faktorit të efikasitetit, ku si pasojë e ul këtë rritje të përshtatjes së kostove për inflacionin, duke ndikuar negativisht në kapacitetin financiar të OSSH-së për të përmbushur kërkesat operative dhe investuese. Ky faktor i efikasitetit, i cili supozon optimizim të vazhdueshëm të kostove, nuk merr parasysh rritjen reale të çmimeve në tregun e energjisë dhe të materialeve, as ndikimin e kërkesave rritëse për shërbime të cilësisë së lartë dhe modernizim të infrastrukturës. Reduktimi i OPEX përmes këtij mekanizmi,



veçanërisht në nivelin e pagave krijon një disbalancë mes pritshmërisë rregullative dhe kapaciteteve reale të kompanisë për të përmbushur këto detyrime, duke rrezikuar qëndrueshmërinë e operacioneve dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

ZRRE-ja duhet të tregojë konsideratë ndaj faktorëve të cilët janë jashtë kontrollit të kompanisë në raport me kërkesat e punonjësve për rritjen e pagave, e që është një faktor esencial për ngritjen e cilësisë së jetesës. Me aprovimin e një rritje të pagave për punonjësit e KEDS, ZRRE-ja do të reflektonte një kujdes edhe ndaj punonjësve të kompanisë sikurse edhe ndaj konsumatorëve.

Çdo punonjës i humbur ka kosto direkte: rekrutim + trajnim + humbje e produktivitetit + risk teknik. Për më tepër, kjo humbje sjell edhe ndikime të mëtejshme në performancën operative dhe financiare të operatorit, duke rritur ngarkesën mbi stafin ekzistues, duke shtuar nevojën për shërbime emergjente dhe duke rritur probabilitetin e gabimeve teknike dhe ndërprerjeve të furnizimit. Kjo tregon se shkalla e lartë e rotacionit të stafit nuk është vetëm një çështje e burimeve njerëzore, por një faktor që ndikon drejtpërdrejt në koston reale të operimit dhe në cilësinë e shërbimit, prandaj duhet të konsiderohet si pjesë e koston së pranueshme në përlogaritjen tarifore.

2.4. Kërkesat për Shpenzimet Operative 2026

OSSH është i obliguar të ndjekë kornizat ligjore dhe rregullative, si dhe të harmonizohet me standardet evropiane për modernizimin e rrjetit, siç përcaktohet në Direktivën e BE për Infrastrukturën e Energjisë, çfarë kërkon rritje të kostove për mirëmbajtje dhe integrim.

Gjatë parashikimit të shpenzime operative për vitin 2026, OSSH është siguruar të ketë përputhshmëri me normat e tregut për pagat, duke ulur lëvizshmërinë dhe rritur moralin e punonjësve. Një staf i qëndrueshëm dhe i motivuar është thelbësor për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjetit, sidomos duke pasur parasysh sfidat teknike dhe operacionale që kërkojnë reagim të shpejtë dhe profesional. Për më tepër, me qëllim që të mundësohen investime në teknologji të avancuar dhe mirëmbajtje të rrjetit, për të garantuar cilësi më të lartë të shërbimeve është e domosdoshme të adresohen sfidat aktuale dhe pritshmëritë e tregut. Thënë kështu, OSSH propozon një rritje të shpenzimeve **operative prej 5% për** vitin 2026 kundrejt nivelit të realizuar të shpenzimeve në vitin 2025. Kjo rritje pasqyron gjithashtu nevojat e funksionimit dhe shtrirjes së OSSH-së në tërë vendin, ofrimin e shërbimeve për furnizuesit e rinj dhe efektet e hapjes dhe zgjerimit të tregut të energjisë. Ajo siguron që OSSH të vazhdojë të përmbushë objektivat strategjike, duke ruajtur stabilitetin operacional dhe duke adresuar pritshmëritë e tregut.

Kjo rritje e propozuar e shpenzimeve operative është jetike për të siguruar stabilitetin financiar dhe operativ të OSSH-së dhe për të përmbushur pritshmërinë e konsumatorëve dhe kërkesat rregullative. Nëse kërkesat e OSSH nuk trajtohen konform masave adekuate, kjo krizë e brendshme aktualisht mund të ketë pasoja afatgjata në qëndrueshmërinë e kompanisë në sektorin energjetik.



Që nga viti 2023, në Republikën e Kosovës kemi qenë dëshmitarë të një rritjeje të ndjeshme të pagës minimale ligjore, si dhe të disa rritjeve të pagave të administratës publike, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e kostos së jetesës dhe konkurrencën në tregun e punës. Paga minimale ishte 170 EUR në vitin 2023, u rrit në 350 EUR në vitin 2024 (rritje rreth 105%), ndërsa për vitin 2026 është parashikuar të rritet në 425 EUR për gjashtëmujorin e parë (rritje rreth 21.4% krahasuar me 350 EUR) dhe më pas në 500 EUR nga korriku i vitit 2026 (rritje rreth 42.9% në raport me 350 EUR). Kjo rritje e vazhdueshme e pagës minimale krijon presion të menjëhershëm mbi pagat e sektorit privat dhe, për pasojë, edhe mbi kostot e punës në sektorin e energjisë, përfshirë KEDS-in.

Në të njëjtën kohë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka rritur pagat e administratës publike disa herë gjatë periudhës 2023–2026, ka pasur të paktën katër rritje të pagave të sektorit publik që nga hyrja në fuqi e Ligjit për pagat në vitin 2023 deri në vitin 2025, duke përfshirë faza të ndryshme të rritjes së njësi-koeficientit dhe shtesa mujore prej 55 EUR që zbatohet në fillim dhe në mes të vitit 2025 për të gjithë punëtorët publikë. Rrjedhimisht, këto rritjet kanë bërë konkurrencën për punonjës me ekspertizë më të lartë në treg të punës edhe më të ashpër. Kjo është e rëndësishme të theksohet, sepse punonjësit e KEDS, si bartës të funksionit të sigurisë së furnizimit me energji elektrike, janë të ekspozuar ndaj ofertave të tjera të punës me paga më të larta, si brenda sektorit ashtu edhe jashtë tij. Në mungesë të njohjes së kostove shtesë të personelit, KEDS nuk ka mundësi të ruajë stabilitetin e stafit dhe të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit me standardet e kërkuara.

Duke marrë parasysh këto rrethana, kërkesa për njohje të rritjes së kostos së personelit në kuadër të shpenzimeve operative për vitin 2026 me këtë aplikim tarifor është e drejtë dhe e justifikuar. Njohja e këtyre kostove nuk është një kërkesë e panevojshme procedurale, por një reflektim i domosdoshëm i kostove reale të funksionimit. Rrjedhimisht, synojmë për të ruajtur stabilitetin operativ të sistemit energjetik dhe për të garantuar furnizim të pandërprerë dhe shërbimet cilësore për konsumatorët. Pa një vendimmarrje të tillë, KEDS rrezikon humbjen e punonjësve kyç, rritjen e rrezikut operativ dhe përkeqësimin e cilësisë së shërbimit, duke krijuar një kosto të paparashikueshme për të gjithë sistemin energjetik.

Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se ky motivim për rritje të pagave është jashtë kontrollit të KEDS, pasi ndryshimet e pagës minimale dhe të pagave të administratës publike janë vendime të qeverisë, të cilat imponojnë një detyrim ligjor dhe social për t'u përshtatur me standardet e reja të pagimit. Në këtë kontekst, ZRRE-ja ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e një ambienti të drejtë dhe të qëndrueshëm rregullator, duke lejuar që kostot reale të punës të reflektohen në tarifë dhe të mos pengojnë funksionimin e qëndrueshëm të operatorit.

Prandaj, në kuadër të këtij aplikimi, kërkojmë mirëkuptimin dhe mbështetjen e ZRRE-së për të njohur rritjen e kostos së personelit si një faktor të paevitueshëm dhe të arsyeshëm, duke siguruar një trajtim të barabartë me sektorin publik dhe me kompanitë simotra, dhe duke ruajtur kështu stabilitetin dhe sigurinë e furnizimit për konsumatorët e Kosovës.



2.4.1. Efekti i rritjes së pagës minimale në Republikën e Kosovës

Rritja e pagës minimale në Republikën e Kosovës, e miratuar me vendim të Qeverisë së Kosovës më 31 tetor 2025, parashikon një rritje të pagës minimale në 425.00 EUR bruto në muaj, duke filluar nga 1 janari 2026, dhe në 500.00 EUR bruto në muaj nga 1 korriku 2026, në kuadër të zbatimit të politikave sociale dhe ekonomike për përmirësimin e kushteve të punësimit dhe mbrojtjen e fuqisë punëtore.

Ky vendim krijon një kosto shtesë operative (OPEX) për OSSH-në që nuk ishte parashikuar në bazën e kostove të miratuara në MYT3 dhe është plotësisht jashtë kontrollit të OSSH-së. Rritja e pagës minimale ndikon në kostot operative për shërbimet e kontraktuara me palë të treta, ku kostoja e punës përbën një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve. Ndryshimi i nivelit të pagës minimale ndikon në: Sigurimin fizik dhe kontrollin e objekteve, Shërbimet e pastrimit dhe higjienës, Mirëmbajtjen e ndërtesave dhe objekteve, përfshirë punë fizike teknike, ku çmimi i kontratës aktuale duhet të rishikohet për të përfshirë rritjen e koston së punës. Përveç këtyre, janë edhe Projektet e tjera me angazhim të fuqisë fizike, të cilat kanë kosto të drejtpërdrejtë të punës si komponent kryesor dhe ndikohen në mënyrë disproporcionale nga ndryshimet ligjore të pagës minimale.

Këto rritje janë rezultat i një vendimi ligjor që imponon kushte të reja pagash, duke tejkaluar parashikimet e buxhetit të OSSH-së dhe duke krijuar kosto të jashtëzakonshme për funksionimin normal të shërbimeve të jashtme që mbështesin infrastrukturën kritike të shpërndarjes së energjisë. Për rrjedhojë, rritja e pagës minimale duhet të njihet si një kosto e paevitueshme dhe jashtë kontrollit të OSSH-së, dhe efektet e saj financiare duhet të reflektohen në hyrat e lejuara maksimale në përputhje me parimet rregullatore të koston së arsyeshme dhe të domosdoshme për sigurimin e shërbimeve me cilësi dhe në mënyrë të pandërprerë.

3. Kostot e Zhvlerësimit dhe Kthimit

Plani i Investimeve i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është i dizajnuar për të mundësuar furnizim të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike me një çmim të arsyeshëm, e njëkohësisht për të siguruar funksionimin e rrjetit në mënyrë transparente dhe në përputhje me parimet komerciale.

Në mars të vitit 2023 përmes vendimit nr.V_1711_2023, ZRRE aprovoi Planin e investimeve për periudhën e tretë rregullative në një total prej 122.07 milion €, ndonëse propozimi i OSSH-së për pesëvjeçarin e ardhshëm ishte 166.87 milion € investime. Këto investime nuk përfshinë edhe nevojën për investimet në 4 komunat veriore, marrë parasysh se marrëveshja hyri në fuqi në 1 janar të vitit 2024, e cila paraqiti nevojën për investime shtesë nga OSSH.



Përderisa OSSH ka bazuar kërkesës për kostot e zhvlerësimit dhe kthimit në Planin e aprovuar të Investimeve për vitet 2023-2027 dhe planet vjetore të aprovuara nga ZRRE. Megjithatë, gjatë vitit 2026, janë identifikuar dhe përfshirë investime shtesë të domosdoshme për pjesën veriore të rrjetit, të cilat janë të nevojshme për të garantuar stabilitetin dhe furnizimin e qëndrueshëm të energjisë në këtë zonë. Këto investime shtesë janë rezultat i zgjerimit të kompetencës operationale të OSSH-së në pjesën veriore, ku më parë infrastruktura dhe shërbimi ishin të paqasshme dhe me standarde të ulëta operationale.

Për më tepër, përmirësimi i gjendjes së rrjetit në këtë zonë është i domosdoshëm për të adresuar sfidat e lidhura me humbjet, ndërprerjet e furnizimit dhe mungesën e investimeve të mëparshme, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për funksionimin e rrjetit dhe shërbimin ndaj konsumatorëve.. E fundit por jo më pak e rëndësishme në aplikim, kostot e zhvlerësimit dhe kthimit janë përshtatur me normën e inflacionit, konform Rregullës për të hyrat e OSSH-së.

Përveç, investimeve për pjesën veriore të cilat nuk janë paraparë në kuadër të MYT 3, për efekt të hapjes së tregut dhe funksionalizimit të tij të qëndrueshëm, në këtë aplikim janë paraparë edhe shpenzime shtesë kapitale për vitin 2026. Këto investime kapitale kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe konsolidimin e tregut të energjisë elektrike, veçanërisht në fushat e teknologjisë së informacionit (IT), modernizimit të sistemeve të matjes (njësorëve) dhe investimeve të tjera mbështetëse. Këto komponentë janë thelbësorë për garantimin e transparencës, saktësisë së të dhënave, menaxhimit efikas të konsumit dhe krijimit të kushteve të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit në treg. Rrjedhimisht, OSSH-ja e ka parë të nevojshme të paraqes kërkesën për mbulimin e kostos shtesë kapitale për vitin 2026 të cilat kanë rrjedhur si rezultat i hapjes së tregut dhe përgatitjes së OSSH-së për fazën tjetër të hapjes së tregut.

4. Kostoja e humbjeve

Një pjesë e rëndësishme e kostove të OSSH është edhe mbulimi i nivelit të lejuar të humbjeve, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të strukturës financiare dhe operative të kompanisë. Sipas dispozitave rregullative, niveli i humbjeve të energjisë që është i lejuar nga ZRRE duhet të përputhet me parametrat e përcaktuar dhe të mbulohet plotësisht për të garantuar stabilitetin financiar të OSSH-së dhe për të siguruar që ofrimi i shërbimit të energjisë të mos ndikohet negativisht nga faktorët e jashtëm.

Sipas nenit 12 të Rregullës për të Hyrat e OSSH-së, OSSH është përgjegjës për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Kostoja e lejuar e humbjeve është kostoja e parashikuar e humbjeve që do të mbulohet nga OSSH për të kompensuar humbjet në sistemin e shpërndarjes dhe do të llogaritet duke përdorur nivelin e lejuar të humbjeve që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike. ZRRE përmes vendimit nr. V_1636_2022, ka aprovuar cakun e reduktimit të humbjeve për periudhën e tretë rregullative 2023-2027, e cila si e tillë është aplikuar gjatë kalkulimit të kostove për nivelin e lejuar të humbjeve për vitin 2026.



Parashikimi i volumeve të energjisë elektrike për qëllime të kalkulimit të kostos së humbjeve është kryer në bazë të draft-bilancit të energjisë për vitin 2026. Në kuadër të aplikimit tarifar, vlerësimi i nivelit të humbjeve në pjesën veriore është bazuar në të dhënat e realizuara dhe informacionet paraprake të raportuara nga kontraktori operativ, të cilat përdoren nga OSSH-ja për qëllime analitike dhe monitoruese të performancës kontraktuale, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në kuadër të marrëveshjes përkatëse.

Në përputhje me udhëzimin e ZRRE-së, prodhimi nga KEK-u alokohet fillimisht tek Furnizuesi i Shërbimit Universal, ndërsa pjesa tjetër ndahet proporcionalisht ndërmjet KEDS dhe KOSTT për mbulimin e humbjeve të shpërndarjes dhe transmetimit. Parashikimi i volumeve për blerjet nga KEK është bërë në bazë të planit të prodhimit të KEK në draft bilancin e energjisë elektrike për vitin 2026 sipas versionit të pranuar nga KEK.

Në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e ZRRE, mbulimi i humbjeve duhet të jetë i saktë dhe i drejtë për të siguruar që OSSH të mos ketë barrë financiare të paarsyeshme dhe që të mund të ofrojë shërbime pa ndërprerje dhe me cilësi të lartë. Kur niveli i humbjeve nuk mbulohet plotësisht ose nuk përlllogaritet saktë, kjo shkakton një dëm të drejtpërdrejtë në kapacitetin financiar të OSSH-së, duke e detyruar atë të mbulojë humbjet përmes importit të energjisë.

Një ndër problemet më të mëdha që OSSH ka hasur është parashikimi i pasaktë i prodhimit vendor ndër vite, që ka ndikuar drejtpërdrejt në nevojën për import të energjisë. Kjo ka shkaktuar implikime serioze për operimin tonë dhe aftësitë tona për të përmbushur kërkesat për energji elektrike. Pamundësia e KEK-ut për të përmbushur detyrimet e veta sipas planit të prodhimit, na detyron të importojmë energjinë me çmime dukshëm më të larta.

Në vitin 2025, OSSH ka importuar mbi 16 milion € më shumë sesa niveli i lejuar nga ZRRE. Kjo është një barrë e rëndë financiare për kompaninë, që përveç kostos së lartë të importit ka rritur edhe kërkesën për burime financiare të tjera, duke e çuar OSSH-në në humbje. Rritja e kostos së importit është veçanërisht e rëndësishme, pasi çmimet e energjisë kanë qenë shumë të paqëndrueshme që nga kriza financiare globale, duke e bërë planifikimin e buxhetit dhe menaxhimin e kostove akoma më të vështirë.

Përveç rritjes dhe destabilizimit të çmimit të energjisë në tregjet ndërkombëtare, OSSH gjatë vitit 2025 është përballur edhe me një rritje të konsiderueshme të kostove të kapaciteteve ndërkufitare. Ky faktor është kritik për të kuptuar natyrën e kostove që duhet të mbulojë OSSH për të ruajtur stabilitetin e sistemit energjetik dhe për të parandaluar një rritje të mëtejshme të kostove të importit, që mund të ndodhin për shkak të mangësive të prodhimit vendor. Reflektimi i saktë i këtyre kostove, si dhe i parashikimeve të energjisë, është jetik për të siguruar që OSSH të mos përballet me humbje të mëtejshme financiare.

Parashikimet e çmimeve të importit, si për energji ashtu edhe për kapacitet, në tregjet ndërkombëtare parashihen të jenë jo stabile edhe gjatë vitit 2026, prandaj parashikimi sa më i drejtë i tyre, është i domosdoshëm. Me qëllim që të sigurohet likuiditet i mjaftueshëm, OSSH në



parashikimin e kostos së humbjeve për vitin 2026 ka përdorur çmimet e pritshme në bursat ndërkombëtare, duke aplikuar edhe kostot e kapacitetit, si kostot shtesë që aplikohet në çmimin përfundimtar.

Megjithatë, me datën 13 janar 2026, KEK ka paraqitur pranë ZRRE-së kërkesën për ndryshimin e çmimeve të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të OSSH-së për periudhën 01.04.2026 – 31.03.2027. Në këtë kontekst, KEK ka propozuar zëvendësimin e çmimit aktual fiks prej 36.00 EUR/MWh me një çmim orar të referencuar në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX).

Ky ndryshim përfaqëson kalimin nga një çmim fiks dhe i parashikueshëm tek një çmim i bazuar në treg, i cili reflekton luhatjet reale të çmimeve të energjisë elektrike në baza orare. Pa paragjykuar kërkesën për ndryshim të çmimit, KEDS ka përgatitur aplikimin tarifor përpara se KEK të paraqiste këtë propozim, dhe për shkak të kufizimeve kohore struktura e re e çmimit nuk është reflektuar në përlogaritjet fillestare. Megjithatë, duke qenë se ky zhvillim përbën një informacion të ri dhe me rëndësi të veçantë, KEDS e vë këtë fakt në dispozicion të ZRRE-së për t'u marrë në konsideratë gjatë shqyrtimit tarifor.

Bazuar në të lartë thënat kostoja e parashikuar e humbjeve nga OSSH për vitin 2026 është 107.1 milion €, siç është paraqitur në tabelën më poshtë:

Inputet për kalkulim	Njësia	2026
Energjia që hyn në shpërndarje	GWh	6,601.26
Lejimi i humbjes	%	12.10%
Humbjet	GWh	914.52
Çmimi i blerjes	€/MWh	117.45
Kostoja e humbjeve	mil€	107,080

Për të ruajtur qëndrueshmërinë e sektorit energjetik dhe të OSSH-së, është e domosdoshme që të bëhet një reflektim i saktë i kostove të humbjeve të lejuara. Një qëndrim i ngurtë nga ZRRE për të mbajtur kostot e ulëta, në kundërshtim me kërkesat e realitetit të tregut dhe faktorëve të jashtëm, po ndikon negativisht në stabilitetin financiar të OSSH-së. Së pari, nëse parashikimi i prodhimit vendor nuk realizohet siç duhet, kjo do të rrisë nevojën për import të energjisë, duke rritur kostot dhe duke e ngarkuar OSSH-në me financime shtesë që nuk mund të mbuloen brenda kuadrit të të hyrave të lejuara.

Mbështetje e plotë për mbulimin e këtyre kostove është jetike për të garantuar që OSSH të mund të ofrojë shërbime të besueshme dhe të qëndrueshme për konsumatorët, si dhe të parandalojë rrezikun e falimentimit dhe destabilizimit të sektorit energjetik. Vetëm me një menaxhim të mirëfillt të kostove dhe me një planifikim të saktë të energjisë mund të sigurohet një e ardhme e qëndrueshme për OSSH-në dhe sektorin energjetik në tërësi.



5. Kostot tjera

Pjesë përbërëse e të hyrave të lejuara maksimale (MAR) janë gjithashtu të hyrat jo tarifore, obligimet ndaj Operatorit të tregut dhe operatorit të sistemit të transmetimit, si dhe çdo kosto tjetër e arsyeshme që ndërlidhet me ofrimin e shërbimeve të sistemit të shpërndarjes.

5.1. Të hyrat e parregulluara

OSSH mbetet e angazhuar për të përmbushur objektivat rregullative dhe për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjithë konsumatorët. Në përputhje me parimet e transparencës dhe eficiencës, procesi i përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale luan një rol thelbësor në krijimin e një mjedisi financiar të qëndrueshëm dhe stimulues për operimin e kompanisë. Ndër të tjera, kjo përfshin edhe mënyrën e trajtimit të të hyrave të realizuara nga shërbimet e përjashtuara, të cilat klasifikohen si të hyra të parregulluara.

Gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale, ZRRE i zbret të hyrat e realizuara nga shërbimet e përjashtuara, të cilat njihen si të hyra të parregulluara. Të hyrat e parregulluara të parashikuara në MAR-in e periudhës së tretë rregullative janë 5.41 milion € për vitin 2026.

OSSH është e përkushtuar për të ruajtur standardet më të larta të shërbimit dhe pajtueshmërisë brenda kuadrit rregullativ. Në përputhje me këtë angazhim, ne kemi identifikuar edhe mundësi për të diversifikuar ofertat tona të shërbimeve jo-tarifore duke ofruar shërbime shtesë përtej atyre që tashmë zbriten nga MAR. Megjithatë, zbritja e plotë e këtyre të hyrave nga MAR, po ndikon edhe në uljen efektive të nxitjes për OSSH-në për të eksploruar dhe investuar në këtë drejtim.

Është thelbësore të kuptohet ndikimi i mekanizmave rregullativë në stabilitetin financiar të OSSH-së dhe aftësinë e saj për të investuar në zhvillimin e shërbimeve dhe infrastrukturës. Prandaj, për të adresuar këtë mundësi dhe për të nxitur inovacionin në sektor, ne propozojmë zbatimin e një faktori ndarës prej 50% mbi të ardhurat e krijuara nga këto shërbime shtesë. Ne besojmë se një faktor ndarjeje prej 50% arrin një ekuilibër të drejtë midis inkurajimit të inovacionit dhe përftimit të konsumatorit fundor, brenda pajtueshmërisë rregullative. Kjo qasje do të na mundësonte të përfitonim nga të hyrat shtesë të gjeneruara, duke kontribuar njëkohësisht në rritjen e përgjithshme dhe qëndrueshmërinë e sektorit të energjisë. Në të njëjtën kohë, kjo qasje do të sigurojë që konsumatorët të përfitojnë nga investimet dhe cilësia e përmirësuar e shërbimeve, ndërsa garanton qëndrueshmërinë financiare të operatorit, veçanërisht në një periudhë me sfida të shtuara financiare dhe nevoja për investime të rëndësishme kapitale.

Ligji për Energjinë Elektrike nënvizon rëndësinë e promovimit të efikasitetit operativ dhe inovacionit, duke siguruar një bazë solide për mbështetjen e kësaj qasjeje. Faktori ndarës prej 50% harmonizohet me këto objektiva dhe garanton që të ardhurat shtesë të përdoren në mënyrë të drejtë



për të mbështetur qëndrueshmërinë financiare të operatorit. Për më tepër edhe rregullat e aprovuara nga ZRRE krijon hapësirën e nevojshme për të adresuar këtë çështje dhe për të ruajtur një ekuilibër ndërmjet operatorit dhe konsumatorëve. Zbatimi i këtij faktori ndarës do të ndikojë pozitivisht jo vetëm në likuiditetin e OSSH-së, por edhe në rritjen e përgjithshme të qëndrueshmërisë dhe përmirësimin e sektorit energjetik.

Në këtë kontekst, OSSH ka aplikuar një faktor ndarës prej 50% në kostot e parashikuara dhe i bëjmë thirrje ZRRE-së që të shqyrtojë me kujdes dhe objektivitet këtë propozim këtë vit, duke njohur ndikimin pozitiv që do të ketë në zhvillimin dhe stabilitetin afatgjatë të sektorit energjetik. Një vendim i drejtë dhe i balancuar do të kontribuojë jo vetëm në mirëqenien e operatorit, por edhe në përfitimin afatgjatë të konsumatorëve dhe të gjithë palëve të interesuara.

5.2. Obligimet ndaj Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit

Gjatë procesit të përcaktimit të të hyrave të lejuara për vitin 2026, është thelbësore të njihen kostot e OSSH-së ndaj Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit si shpenzime të domosdoshme për funksionimin e rrjetit dhe sigurimin e një shërbimi të vazhdueshëm e të qëndrueshëm për konsumatorët. Si të tilla, ato janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me detyrimet ligjore dhe operative të OSSH-së.

Kostot e parashikuara për obligimet e OSSH-së ndaj Operatorit të Tregut dhe Sistemit për vitin 2026 janë 4.26 million €. Këto kosto janë parashikuar bazuar në tarifave aktuale të aprovuara dhe humbjeve të parashikuara për vitin 2026. Çdo ndryshim në tarifat e OST-së duhet të reflektohet nga ZRRE para përcaktimit të MAR-it përfundimtar për OSSH-në.

Njohja e këtyre kostove si pjesë e të hyrave të lejuara është kritike për të siguruar që OSSH të ketë burimet e nevojshme financiare për të përmbushur këto obligime dhe për të shmangur çdo ndikim negativ në funksionimin e rrjetit apo në cilësinë e shërbimeve të ofruara.

6. Faktori korrigjues i të hyrave – KREV

Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale, OSSH ka bërë korrigjimin e të hyrave të vitit 2025, i cili aplikohet duke llogaritur dallimin ndërmjet vlerave të parashikuara për vitin tarifar 2025 dhe atyre të realizuara.

Për herë të parë që nga privatizimi, OSSH ka arritur nivelin e lejuar të humbjeve gjatë vitit 2025, një arritje që dëshmon angazhimin për përmirësimin e eficiencës operative. Megjithatë, për shkak të parashikimit jo të saktë të energjisë së prodhuar në vend, është shfaqur nevoja për të mbuluar kërkesën përmes importit të energjisë elektrike. Çmimet e larta të importit kanë rezultuar në një



kosto shtesë prej mbi 16 milion € krahasuar me nivelin e lejuar nga ZRRE, të cilat kanë vështirësuar operimet dhe renduar pozitën financiare të OSSH-së.

Megjithëse tarifat e miratuara për vitin 2025 në praktikë kanë filluar të zbatohen nga muaji maj 2025, ndërsa në kuadër të përllogaritjes tarifore dhe përcaktimit të të hyrave të lejuara të njëjtat janë supozuar të aplikueshme që nga muaji janar 2025. Ndërkohë, gjatë periudhës janar–prill 2025, OSSH ka vazhduar faturimin e konsumatorëve me tarifat e vitit 2024, të cilat ishin ndjeshëm më të ulëta krahasuar me tarifat e miratuara për vitin 2025. Si rezultat, të hyrat e realizuara në këtë periudhë nuk kanë reflektuar nivelin e kostove të supozuara në vendimin tarifor, duke krijuar një boshllëk financiar të menjëhershëm për operatorin.

Aplikimi i vazhdueshëm i kësaj qasjeje ndër vite krijon një efekt kumulativ negativ për OSSH, pasi mos mbulimi i të hyrave nga vonesa në zbatimin e tarifave nuk kompensohen në mënyrë të plotë dhe simetrike përmes mekanizmave korigjues tariforë. Në praktikë, kjo rezulton në transferim të rrezikut financiar tek operatori, në kundërshtim me parimet e stabilitetit financiar dhe rikuperimit të plotë të kostove.

Si pasojë direkte e kësaj mospërputhjeje, OSSH nuk ka qenë në gjendje të mbulojë plotësisht koston reale të energjisë së importuar gjatë vitit përkatës, duke rezultuar në një hendek financiar prej mbi 41.86 milionë euro, siç evidentohet në analizën përkatëse financiare.

Për këto arsye, konsiderohet e domosdoshme rishikimi i trajtimit të periudhës së zbatimit të tarifave në kuadër të modelit tarifor, me qëllim harmonizimin e supozimeve rregullative me realitetin operacional dhe sigurimin e reflektimit të plotë dhe në kohë të kostove reale në tarifë.

Faktori korigjues i të hyrave - KREV	Njësia	2026
AACat-1	mil€	203.77
ARRt-1	mil€	165.39
It	%	9.05%
KREV = (AACat-1 - ARRT-1)*(1+It)	mil€	41.86

Është e rëndësishme të theksohet se, barra financiare e krijuar nga kostot e paparashikuara po krijojnë presion të madh mbi likuiditetin dhe stabilitetin operativ të OSSH-së. Çdo mosreflektim i këtyre kostove në mënyrë të saktë dhe të plotë rrit rrezikun për operim dhe zvogëlon kapacitetin për të bërë investime të nevojshme në infrastrukturë dhe shërbime. Për më tepër, vonesat ose devijimet në përcaktimin e kostove reale nga viti në vit po krijojnë pasiguri në parashikimet financiare dhe operative, duke vështirësuar planifikimin afatgjatë.

Për të garantuar një mjedis të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm për ofrimin e energjisë elektrike, është thelbësore që ZRRE të njohë dhe reflektojë në mënyrë të drejtë këto kosto në të hyrat e lejuara për vitin 2026. Gjithashtu edhe reflektimi i saktë i tarifave aktuale gjatë tremujorit të parë është



thelbësor për të siguruar një pasqyrim më të drejtë të kostove dhe për të shmangur pabarazitë që krijohen nga disbalanca ndërmjet viteve tarifore. Reflektimi i sakte dhe me kohe i kostove do të kontribuojë në një sistem më të qëndrueshëm dhe më të drejtë për të gjitha palët e përfshira.

7. Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026

Duke marrë parasysh të gjitha kostot e prezantuara në seksionet e mëparshme dhe në përputhje me formulën e dhënë në shtojcën 1 të Rregullës për të hyrat e OSSH-së, OSSH ka kalkuluar kërkesën për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026 si vijon:

Te hyrat e lejuara maksimale-MAR	2026 (mil€)
Shpenzimet Operative	39.39
Zhvlerësimi	24.61
Kthimi	20.08
Kostoja e humbjeve	107.46
Obligimet për OST-në	4.26
Të hyrat e parregulluara	0.09
Përshtatjet për PR2	(2.70)
Faktori korrigjues_KREV	41.86
MAR	235.05

Kërkesa e OSSH për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026 në vlerën prej 235.05 milion € siguron operim të qëndrueshëm të operatorit të sistemit të shpërndarjes, ofron shërbime më cilësore ndaj konsumatorëve dhe gjithashtu do ta ruaj stabilitetin financiar të OSSH-së. Në këtë mënyrë, do të mundësohet ofrimi i shërbimeve më cilësore ndaj konsumatorëve, përfshirë mbulimin e humbjeve në rrjet dhe garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike.

Çfarëdo tendence për të zvogëluar kërkesën e OSSH-së do të rrezikoj likuiditetin financiar të OSSH-së dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike. Për më tepër, kjo do të ndikonte negativisht në kapacitetin e OSSH-së për të përmbushur detyrimet e tij dhe do të minonte besimin e konsumatorëve dhe investitorëve në sektorin energjetik.

Në këtë kontekst, kërkojmë një reflektim të drejtë dhe të plotë të kostove të nevojshme për operimin e OSSH-së, për të siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike në të ardhmen. Rregullimi i drejtë dhe i saktë i të hyrave të lejuara është kyç për garantimin e një sektori energjetik të qëndrueshëm dhe të besueshëm për konsumatorët dhe ekonominë e Kosovës.